

Nr. Prot.

474/1

Nr. Prot.

Tiranë, 14.04.2023

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

Universiteti Barleti (UniBa) Institucion i Arsimit të Lartë, me adresë në rr. Frang Bardhi, Nr. 118, Tirane, përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Suzana Guxholli.

Dhe

FIX PRO Sh.p.k (FIX PRO) Subjekt privat, i cili ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit, përpunimit dhe tregëtimit të mishrave, prej vitit 2003. Adresa: Lagjja 1, Rr "Eordej" (Korçë-Bilisht, km 1), Korçë, Shqipëri.

Preambul: Motivi i këtij bashkëpunimi UniBa-FIX Pro Sh.p.k

Situata aktuale, e shënuar nga një rritje e theksuar e çmimeve të energjisë dhe lëndëve të para, si dhe nga ndikimi i ndryshimeve klimatike, paraqet kërcënim të rëndësishëm për zhvillimin e aktiviteteve prodhuese, ashtu edhe për ndërtimin e infrastrukturave të reja prodhuese. Qëndrueshmëria e objekteve dhe infrastrukturës prodhuese është një sfidë e madhe për industrinë përpunuese, pronarët e objekteve dhe linjave prodhuese, por dhe për autoritetet lokale e ato qendrore. Megjithë rritjen e ndërgjegjësimit të pronareve për rëndësinë e adoptimit të praktikave të qëndrueshme si në menaxhimin, ashtu edhe në ndërtimin e objekteve prodhuese, nuk ka përputhshmëri gjithmonë, me aftësinë aktuale të menaxherëve dhe stafit teknik e punonjësve të ndërmarrjeve prodhuese, për të zbatuar masa konkrete për të rritur qëndrueshmërinë e infrastrukturës së tyre.

Neni 1

Qëllimi dhe Objekti

Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e bashkëpunimit mes institucioneve firmëtare, duke përcaktuar detyrimet e secilës palë.

Objekti i kësaj marrëveshje është bashkëpunimi dhe mbështetja reciproke në aplikimin e zbatimin e projekteve dhe nismave në sektorët e mëposhtëm:

- Ngritjen e një modeli dhe praktike të mirë për Ekonominë Qarkulluese;
- Ngritjen e një modeli dhe praktike të mirë për Eficiencën e Energjisë dhe Burimeve Alternative të Energjisë, që merr në konsideratë komponentët fizikë të një impianti industrial (truall, godina, impiante teknike, paisje, lënda e parë);
- Studime Fizibiliteti, Analizë, Konsulencë si dhe gjetje e propozime konkrete novatore për sa më sipër;
- Ngritjen e një modeli dhe praktike të mirë për Prodhimin e Qëndrueshëm dhe të Shëndetshëm;
- Realizimin e një Fushate Promovimi për një produkt të ri;
- Hartimin e Programit *Fix Nutrition*;
- Pjesëmarrja në praktikat mësimore të studentëve të UniBa në FIX Sh.p.k;
- Platforma dhe forume mbi tema specifike të sektorit;
- Shkëmbimi i praktikave të mira, në aspektin manaxherial dhe të lidërshit;
- Kurse dhe Certifikime Teknike - Profesionale për stafin.

Neni 2 Kohëzgjatja e marrëveshjes

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e firmosjes nga përfaqësuesit e të treja palëve në datën /04/2023 dhe mbetet në fuqi për 2 (dy) vite nga data e firmosjes.

Me përfundimin e afatit, me kërkesën me shkrim të palëve, kjo marrëveshje mund të rinovohet për një afat tjetër 2 (dy) vjeçar.

Neni 3 Informacion mbi palët

1. **Universiteti BARLETI** është një universitet privat, i cili ndër vite ka promovuar një nivel të lartë edukimi dhe kërkimi shkencor dhe aplikativ, Përmes edukimit cilësor UniBa synon të zhvillojë prirjet e cdo studenti, me objektivin e krijimit të eksperteve më të mirë, të aftë për të konkuruar në tregun ndërkombëtar. Misioni i Universitetit është krijimi i një institucioni akademik elitare, bazuar në praktikatat e vlerat me të mira ndërkombëtare, me programe shumëdisiplinore të vënë në jetë nga akademikët më të mirë shqiptarë. Me anë të kërkimit shkencor, UniBa synon të përmiresojë teoritë dhe të kuptuarit ose parashikimin e fenomeneve të natyrës, shoqërisë, ekonomisë dhe me komponentin e kërkimit të aplikuar, synon zgjidhjen e problemeve të së përditëshmes, rezultatet e së cilit kanë efekt të menjëhershëm dhe praktik.
2. **FIX PRO Sh.p.k** (www.fixpro.al) ushtron aktivitetin në fushën e prodhimit, përpunimit dhe tregëtimit të mishrave dhe nënprodukteve të mishit, prej vitit 2003. Themeluesi i saj, Z. Nesti TARUSHA, që nga viti 1992, e filloi aktivitetin si distributor ekskluziv i markave ndërkombëtare të erëzave, aromave dhe aditivëve për sallameritë e ndryshme. Sot, FIX PRO Sh.p.k vazhdon të jetë e fokusuar në tregun dhe industrinë ushqimore, duke synuar gjithmonë performancën më të lartë dhe më të suksesshme në tregun e sotëm, me diversitet të lartë dhe në zhvillim, duke ofruar vlera, shërbime dhe produkte të shkëlqyera ushqimore, për klientët sot, nesër dhe për gjeneratat që do të vijnë. FIX PRO Sh. p.k ka për mision mungesën e kompromisit sa i takon kualitetit; vlerëson transparencën në komunikimin me klientët dhe me partnerët; përpiqet që jo vetëm të ofrojë produkte me standarde evropiane, të cilat dallohen për shijen e veçantë, cilësinë dhe paketimin, por edhe të minimizojë ndikimin negativ në mjedis; investon në përmirësimin e teknologjisë së prodhimit dhe në zgjerimin e aktivitetit dhe tregon kujdes në investimin dhe zhvillimin profesional dhe personal të punonjësve, si garanci për zhvillimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të kompanisë.

Neni 4 Të drejtat dhe detyrimet e partnerëve

1. Universiteti BARLETI (në vijim UniBa):

- a) UniBa angazhohet në bashkëpunim me partnerin, për të ndërmarrë të gjitha nismat dhe hapat e nevojshëm organizative për programimin e cdo aktiviteti e nisme të rënë dakord midis palëve në zbatim të objektit të kësaj marrëveshje.
- b) UniBa angazhohet në bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në projekte, trajnime, workshope, forume, konferenca, konsultime, fushata informimi, promovimi e ndergjegjësimi etj;
- c) UniBa angazhohet të mbështesë dhe t'i ofrojë kontribut palëve në marrëveshje, duke vendosur në dispozicion stafin e saj akademik në përputhje me ekspertizën e kërkuar nga projekti/ iniciativa;
- d) Personat e kontaktit do të jenë: Z. Ledio KOSTA, me adresë e-mail: l.kosta@umb.edu.al dhe znj. Kejda NUHU, me adresë e-mail: co.research@umb.edu.al.

2. FIX Pro:

- a) FIX Pro do të kërkojë ekspertizë në fushën që institucioni partner mbulon, në përputhje me kërkesat dhe kriteret për një ekspertizë të caktuar;

- b) FIX Pro do të punojë së bashku me institucionin partner & përmes nismave të përbashkëta, duke ngritur grupe pune;
- c) FIX Pro shpreh vullnetin për të bashkëpunuar e sjellë rezultate pozitive në drejtim të partneritetit dhe realizimit të objektivave.
- d) Personat e kontaktit do të jenë:
 - 1. COO, Z. Reis ANDRANJI, me adresë e-mail: reisandranji@fixpro.al; +355684063919;
 - 2. Menaxhere e Burimeve Njerëzore, Znj. Xhensina KAPO; hr@fixpro.al; +355684090506;
 - 3. Menaxheri R&D, Z. Lazjon PETRI; lazjonpetri@fixpro.al; +355686023918.

3. Palët bashkarisht bien dakord si vijon:

- a) Te punojnë së bashku në drejtim të ngritjes së një modeli dhe praktike të mirë për Ekonominë Ciklike - Eficienten e Energjisë dhe Burimeve Alternative të Energjisë - Prodhimin e Qendrueshëm dhe të Shëndetshëm;
- b) Të jenë në kontakt për cdo thirrje të mundshme dhe mundësi bashkëpunimi në partneritet;
- c) Të zbatojnë programet dhe projektet e përbashkëta me interes publik si dhe shkëmbimin e informacionit e dokumentacionit, i cili do të përdoret vetëm për qëllime të realizimit të projekteve;
- d) Te bashkëpunojnë në cdo fushë tjetër të pa listuar me sipër, brenda objektit të tyre dhe për të cilët palët kanë kapacitetet e përshtatshme profesionale.

Neni 5 Dispozitat e fundit

Kjo marrëveshje mund të ndryshohet në bazë të konsensusit ndërmjet palëve firmëtare, të shprehur në një dokument të shkruar.

Mosrespektimi i detyrimeve që rrjedhin nga kjo marrëveshje bashkëpunimi, nga njeri prej partnereve, con detyrimisht në prishjen e saj. Vullneti për mbarimin e marrëveshjes para afatit, komunikohet me shkrim nga partneri, duke argumentuar arsyet e këtij veprimi.



Kjo marrëveshje përmban 3 (tre) faqe dhe hartohet në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje origjinale me të njëjtën vlerë.

Duke marrë parasysh përcaktimet e mësipërme palët ranë dakord.

Universiteti Barleti

Rektor

Prof. Dr. Suzana GJERAMI



FixPro sh.p.k

Administrator

Z. Nesti TARUSHA



SHTOJCË

Shërbime në bashkëpunim:

1. EFICENCA E ENERGJISË DHE BURIMEVE

Realizohet në bashkëpunim me Departamentet dhe Studentet e Arkitektures dhe Shkencave Komjuterike, mbi këto komponente:

Eficiency e Energjisë në Ndërtesa Industriale dhe Linjat e Prodhimit:

- Studim Fizibiliteti për Eficiency Energjitike në 2 Kapanonet dhe Linjat Prodhuese (Korce dhe Tirane)
- Matje dhe Auditim të Eficiency Energjitike në 2 Godinat;
- Certifikimi i Godinave sipas legjislacionit në fuqi;
- Matjet dhe Auditim të Eficiency Energjitike në 2 Linjat e Prodhimit;
- Certifikimi i Linjave sipas legjislacionit në fuqi;
- Të dhënat dhe UA për mbajtjen e gjurmëve të modeleve të konsumit të energjisë;

Burimet e Qëndrueshme dhe të Riciklueshme Alternative të Energjisë:

- Studimi i mbulimit të kapanoneve prodhuese me panele diellore;
- Instalimi Sistemeve të paneleve diellore në taraca;
- Burimet e qëndrueshme të energjisë (p.sh. gjeotermike, era);
- Sisteme të qëndrueshme ngrohje;
- Sisteme të qëndrueshme ndriçimi.

2. EKONOMIA CIKLIKE dhe PRODHIM I QËNDRUESHËM:

- Zhvillim i Qëndrueshëm në Ndërtim dhe Prodhimtari;
- Reduktimin e gjurmës mjedisore të objekteve prodhuese;
- Objektet me shumë qëllime për reduktimin e konsumit të tokës;
- Përdorimi i materialeve të ricikluara për pajisje, terrene dhe sipërfaqe të shfrytëzueshme;
- Dizajn dhe ekodizajn i qëndrueshëm;
- Izolimi i objekteve të brendshme;
- Zakonet e përgjithshme të menaxhimit të qëndrueshëm.

3. 'FUSHATA PROMOVIMI PËR NJË PRODUKT TË RI'

Realizohet në bashkëpunim me Departamentin dhe Studentet e Biznesit mbi këto komponente:

- Pyetësor për spotin televiziv dhe fushatën marketing (min 500 student);
- Brendimi i një produkti të ri (minimum 5 propozime nga studentet);
- Spoti publicitar dhe paketimi (2-3 ide dhe realizimi i versionit final);
- Prezantimi i produktit final me studentet e Barletit por dhe në rrjetet e komunikimit Barleti; po kështu në platformen e FIX dhe media dixhitale.

4. Hartimi i programit "FIX NUTRITION"

Realizohet në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Mjeksore dhe Departamentin e Sporteve mbi këto komponente:

- Konservantët Natyral;
- Produkte Vegane;
- Sporti Korporativ – Praktika e ekipeve sportive amatore;
- Ritje Kapacitetesh.

5. Aktivitete Mbështetëse:

Vizita studimore të studentëve dhe pedagogëve BARLETI në ambientet e fabrikës në Korçë;
Prezantimi i “Praktikës së Mirë FIX” në sallën e Forumit më perfaqësues të Kompanisë dhe BERZH;
Prezantimi i “Praktikës së Mirë FIX” në FORUMIN për SMART CITY dhe mundësia përfshirjes në projektet me donatorë të ndryshëm.

Shtirirja e këtij modeli bashkëpunimi dhe në fusha të tjera:

Projekti i përgjithshëm nuk duhet të konsiderohet si një i vetëm, por si themeli i një bashkëpunimi më të gjerë dhe angazhim i partnereve për krijimin e bizneseve prodhuese më të qëndrueshme me ndikim pozitiv në shëndet të konsumatorëve, rritjen e mirëqenies së punonjësve dhe aspekte të tjera sociale e ekonomike.

Shtirirja e këtij modeli bashkëpunimi fushën e trajnimeve dhe certifikimeve:

Synohet të krijohet një ekosistem bashkëpunues me biznesin duke i strukturuar modulet në funksion të teknologjive të reja dhe nevojave që kanë bizneset të cilat operojnë në këto fusha dhe të shkëmbehen këto njohuri me profesionistët dhe stafin.

Kurset dhe Certifikimet Tekniko-Profesionale në bashkëpunim:

- Auditues Energjistik në Ndërtesa;
- Auditim Energjistik në Instalime Industriale;
- Menaxher Energjie;
- Përdorues i gazeve-F dhe substancave ozon holluese.

Kurse të tjera plotësuese:

- Rritja e Biznesit;
- Lidërshipi dhe Menaxhimi;
- Drejtimi Strategjik;
- Menaxhim projektsh;
- Biznesi i vogël;
- Prodhimi dhe shpërndarja;
- Menaxhimi i logjistikës;
- Tregtimi;
- Vlerësues i Pasurive të Paluajtshme;
- Legjislacioni Mjedisor;
- Menaxhimi Mjedisor dhe Social;
- Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis;
- Shëndeti dhe siguria në punë.

Angazhimi i Stafit Akademik dhe Teknik si dhe Studentëve të Universitetit BARLETI do të jetë në bashkëpunim të ngushtë me Stafin Drejtues, Menaxherial dhe Tekniko Professional të Kompanisë FIX PRO.





SHITOCË

Për pjesëmarrje të përbashkët në thirrjen për *Projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit për vitin 2023-2024 (Projektet vijnë si propozime të Universitetit me Biznesin)* të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit

Palët dakordësohen për:

- aplikim të përbashkët në thirrjen e AKKSHI-t dhe
- bashkëfinancimin në raportin 70% financim grant nga AKKSHI dhe 30% financim nga biznesi për realizimin e projektit.

Për projektin *"Optimizimi dhe rritja e produktivitetit me anë të masave të efikasitetit të energjisë në godinat dhe linjat e prodhimit të kompanisë FLX Pro sh.p.k"* i cili konkretizohen objektivat dhe produktet e mëposhtme:

- 1-Ngritja e një modeli dhe praktike të mirë për Efikasitetin e Energjisë dhe Burimeve Alternative të Energjisë që merr në konsideratë komponentët fizik të një impianti industrial (truall, godina, impiante teknike, pajisje, lënda e parë);
- 2-Studime Fizibiliteti, Analizë, Konsulencë si dhe gjetje e propozime konkrete novatore për sa më sipër;
- 3-Hartimi i një plani masash i bazuar në studimin e fizibilitetit, të integruar me planin e investimeve;
- 4-Mbikqyrja e zbatimit të planit të masave, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i të dhënave të grumbulluara;
- 5-Ngritja e një modeli dhe praktike të mirë për Prodhimin e Qëndrueshëm dhe të Shëndetshëm; të marrëveshjes të përgjithshme të bashkëpunimit.

Universiteti Barleti
Rektor
Prof. Dr. Suzana Anxhelli



FixPro sh.p.k
Administrator
Z. Nesti Tarusha



